



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2023:070411
Datë: 28.05.2024
Numri i dokumentit: 05744921

PA1.nr.734/2023

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS – kolegji i përbërë nga gjyqtarët Zyhdi Haziri, - kryetar i kolegjit, Skender Çoçaj dhe Ferit Osmani, anëtarë, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtores profesionale Ilmije Rexhepi Beqiri si procesmbajtëse, në çështjen penale kundër të akuzuarit F.B nga Gjilani, për shkak të veprës penale, Vjedhje në vazhdimësi nga neni 313 par i lidhur me nenin 77 të KPRK-së, duke vendosur përkitazi me ankesën Prokurorisë Themelore në Gjilan, të ushtruar kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Gjilan, Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Penal, P.nr.261/2023 të dt.14.04.2023, në seancën e kolegjit të mbajtur, me datë 23.05.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHET si e pabazuar ankesa e Prokurorisë Themelore në Gjilan, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Gjilan, Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni Penal, P.nr.261/2023 të dt.14.04.2023, **VËRTETOHET**.

A r s y e t i m i

Gjykata Themelore në Gjilan, Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni Penal, me aktgjykimin P.nr.261/2023 të dt.14.04.2023, të akuzuarin F.B e ka shpallur fajtor për shkak të veprës penale, dhe i ka shqiptuar dënim me gjobë në vlerë prej 200 (dyqind) euro, dhe dënim me burg në kohëzgjatje prej 100 (njëqind) ditë. Në bazë të nenit 44 të KPRK-s, dhe me pëlqimin e të pandehurit F.B dënimi me burgim në kohëzgjatje prej 100 (njëqind) ditë, i zëvendësohet me dënim me gjobë në shumë prej 600 (gjashtëqind) euro. I akuzuari F.B obligohet të paguaj shumën totale prej gjithsej 800 (tetëqindë) euro në afat prej 30 (tridhjetë) ditë pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi. Nëse i pandehuri refuzon të paguajë dënimin me gjobë ose nuk është në gjendje

ta paguaj atë atëherë dënimi me gjobë me pajtim me të pandehurin zëvendësohet me punë në dobi të përgjithshme ashtu që 8 (tetë) orë të punës do të barazohen me 20.00 € (njëzet euro) ndërsa nëse i pandehuri nuk pajtohet me zëvendësimin e dënimit me gjobë në punë në dobi të përgjithshme atëherë dënimi me gjobë do të zëvendësohet në dënim me burgim në atë mënyrë që për çdo 20.00 € (njëzet euro) do ti caktohet një ditë burgim. Konform nenit 79 të KPRK-s, koha e kaluar në paraburgim nga data 19.03.2023 e deri më datë 18.04.2023 do ti llogaritet në dënimin e shqiptuar me gjobë. Palët e dëmtuara për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohen në kontest civil. Obligohet i pandehuri që të paguaj taksën për Kompensimin e Viktimave të krimit në shumë prej 20.00 (njëzetë) euro, në afat prej 15 ditë pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarrimit të dhunshëm. Obligohet i akuzuari që të paguaj shpenzimet e procedurës penale dhe paushallin gjyqësor në shumën prej 20.00 € (njëzetë euro), në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarrimit të dhunshëm.

Kundër këtij aktgjykimi brenda afatit ligjor ankesë ka paraqitur:

Prokuroria Themelore në Gjilan, për shkak të vendimit mbi sanksionin penal, me propozim që gjykata e Apelit ta ndryshoj aktgjykimin e ankimuar lidhur me vendimin ashtu që i akuzuarit për veprën penale ti shqiptohet një dënim më i lart me gjobë si dhe dënim me burgim efektiv.

Përgjigje në ankesë ka parashtruar mbrojtësi i të akuzuarit F.B, Av. A.G duke propozuar që të refuzohet ankesa e Prokurorisë themelore në Gjilan dhe të vërtetohet aktgjykimi i ankimuar.

Prokurori i Apelit, me parashtrësën me shkrim PPA/II.nr.769/2023 të datës 15.06.2023, ka propozuar që të aprovohet si e bazuar ankesa e Prokurorisë Themelore në Gjilan të ndryshohet aktgjykimi i ankimuar akuzuarit për veprën penale në vazhdimësi, Vjedhje nga neni 313 par. 1 lidhur me nenin 77 të KPRK-s ti shqiptohet një dënim më i lart me gjobë si dhe dënim me burgim efektiv.

Gjykata e Apelit e Kosovës, pasi që shqyrtoi të gjitha shkresat e kësaj çështje juridike penale, studioj aktgjykimin e ankimuar në pajtim me dispozitën e nenit 394 të KPP-së, dhe pasi vlerësoi pretendimet e cekura në ankesë, gjeti se:

-Ankesa nuk është e bazuar.

Edhe pse aktgjykimi i shkallës së parë nuk është atakuar për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës penale, Gjykata e Apelit të njëjtin sipas detyrës zyrtare e shqyrtoj dhe në këtë aspekt konform dispozitës së nenit 394 të KPP konstatoj se ai nuk përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale si dhe as shkelje të ligjit penal në dëm të të akuzuarit e të cilat do të kishin kushtëzuar anulimin e tij.

Prokuroria Themelore në Gjilan, e ankimon aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë për shkak të vendimit mbi sanksionin penal me pretendimet se në rastin konkret se Gjykata

Themelore, të akuzuarit nuk i ka shqiptuar dënimin e merituar në pajtim me ligjin, sepse sanksioni-dënimin i shqiptuar është në kundërshtim me rregullat e përgjithshme mbi matjen dhe caktimin e drejtë të dënimit të përcaktuar me nenin 69, 70, 71 dhe 72 të KPRK-së. Rrethanat lehtësuese çfarëdo qofshin ato, në rastin konkret nuk kanë mundur të vlerësohen në këtë masë dhe tu jepet rëndësi e tillë duke ndikuar që dënimin e parashikuar ligjor që për këtë veprë penale të zbutet gjerë në këtë nivel si në aktgjykimin e atakuar. Dënimin i shqiptuar në rastin në fjalë, nuk është në përputhje me dënimin e merituar, për faktin se jo vetëm që nuk i është shqiptuar dënim adekuat në pajtim me veprimet e tija, mënyrën e kryerjes, shkallën e përgjegjësisë pasojën e shkaktuar etj, por edhe për arsye se gjykata si rrethanë lehtësuese ka marrë faktin se i njëjti ka pranuar fajësinë për veprën penale të cilën i vihet në barrë, se i njëjti i ka premtuar gjykatës që në të ardhmen nuk do të kryej vepra të tilla dhe as vepra të tjera penale, se i pandehuri është penduar për veprën e kryer, e që sipas vlerësimit tonë nuk është dashur të merren parasysh rrethanat e tilla si rrethana lehtësuese për faktin se vepra penale e kryer nga ana tij është e natyrës së tillë që nuk mund të lejohet që pranimi i fajësisë të merret rrethanë lehtësuese, duke pasur parasysh të mirën e mbrojtur, respektivisht pasurin e të dëmtuarave, gjithashtu rrethanë lehtësuese nga ana e gjykatës nuk ka pas vend të merret premtimi i të njëjtit se në të ardhmen nuk do të kryej veprë penale duke pas parasysh se i njëjti edhe në të kaluar ka kryer vepra të ngjashme penale dhe prapë me datë 19.03.2023 ka ripërsëritur veprimet që përmbushin elemente të veprës penale. Gjithashtu se dënimin i shqiptuar për të pandehurin nuk është në përputhje me dënimin e merituar dhe të nevojshëm për t'u arritur qëllimi i dënimit ashtu siç është paraparë në kod dëshmon edhe fakti se gjykata nuk ka marrë për bazë fare se si rrethanë rënduese prokuroria ka propozuar të merret edhe fakti se i pandehuri është recidivist i veprave të njëjta penale dhe ndaj ti edhe në momentin kur është mbajtur gjykimi ka pasur aktive, respektivisht të paraqitura para gjykatës tre aktakuza për lloje të natyrës së njëjtë të veprave penale dhe atë: PP.II.NR. 240/2023 dt 01.02.2023, PP.II.NR.247/2023 – dt. 02.02.2023 dhe PP.II.NR. 330/2023 dt 21.02.2023.

Gjykata e Apelit e Kosovës, vlerëson se pretendimet ankimore, nuk janë të bazuara. Kjo për faktin se gjykata e shkallës së parë në përgjithësi drejtë i ka konstatuar dhe vlerësuar rrethanat të cilat ndikojnë në caktimin e llojit dhe lartësisë së dënimit, ndërsa në ankesën e lartcekur nuk është paraqitur ndonjë rrethanë e rëndësishme dhe e posaçme e cila do ta arsyetonte shqiptimin e dënimit me gjobë më të lartë dhe dënim me burg efektiv për të akuzuarin. Kolegji penal i kësaj gjykate vlerëson se gjykata e shkallës së parë, gjatë matjes së shqiptimit të dënimit në pajtim me dispozitat e nenit 69 të KPK-së, pati parasysh të gjitha rrethanat e rastit konkret të cilat janë me ndikim me rastin e marrjes së vendimit, ashtu që si rrethana lehtësuese mori pranimin e fajësinë, se i pandehuri është penduar, dhe i ka premtuar gjykatës që në të ardhmen nuk do të kryej vepra tjera penale, ndërsa si rrethana rënduese gjykata gjeti dënimin e shkaktuar të dëmtuarave, rrezikshmërinë shoqërore të veprës penale dhe përgjegjësinë penale.

Një vlerësim të këtillë të rrethanave relevante për matjen e dënimit si të drejtë dhe të ligjshëm e pranon edhe kjo gjykatë dhe gjen se gjykata e shkallës së parë drejtë dhe në mënyrë të plotë i ka vlerësuar rrethanat të cilat ndikojnë në caktimin e llojit dhe lartësisë së dënimit, ndërsa pretendimet e prokurorisë themelore për të shqiptuar një dënim me gjobë më të lartë dhe dënim me burg efektiv konsideron se janë të pabazuara. Ngase të gjitha këto rrethana, e sidomos duke marrë parasysh faktin se i akuzuari ka pranuar fajësinë, se i pandehuri është penduar, dhe i

ka premtuar gjykatës që në të ardhmen nuk do të kryej vepra tjera penale, po ashtu marrë parasysh rrethanat personale të akuzuarit se është i gjendjes së varfër ekonomike, është baba i tre fëmijëve është i pa punë si dhe faktin se nga shkresat e lëndës nuk rezulton se i njëjti është i dënuar edhe më parë, ndërsa pretendimin e prokurorisë se i akuzuari ka pasur aktive, respektivisht të paraqitura para gjykatës tre aktakuza për lloje të natyrës së njëjtë të veprave penale, bie në kundërshtim me parimin e prezumimit të pafajësisë, pasi që një person konsiderohet i dënuar vetëm kur është dënuar me aktgjykim të formës së prerë. Në këto rrethana sipas vlerësimit të kolegjit penal të kësaj gjykate japin bazë të mjaftueshme që arsyetojnë shqiptimin e dënimit nga gjykata e shkallës së parë si në dispozitiv të aktgjykimit të ankimuar, dhe se dënimi i shqiptuar ndaj të akuzuarit është në harmoni me intensitetin e rrezikshmërisë shoqërore të veprës penale të kryer, me shkallën e përgjegjësisë penale të akuzuarit si ekzekutor, rrethanat personale të akuzuarit dhe se kjo do t'i shërbej preventivës gjeneralë, posaçërisht asaj individuale, forcimit të moralit të shoqërisë, si dhe përgjegjësisë dhe disiplinës së qytetarëve dhe se me këtë kryerësit do të parandalohen nga kryerja e veprave penale në të ardhmen, si dhe do të bëhet rehabilitimi i tyre. Andaj kolegji penal i kësaj gjykate konsideron se dënimi i shqiptuar është i mjaftueshëm për tu arritur qëllimi i dënimit i paraparë me dispozitën e nenit 38 të KPRK-së.

Nga sa u tha më lartë, e në bazë të nenit 401 të KPPRK-së, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS
Departamenti i Përgjithshëm
PA1.nr.734/2023, më datë 23.05.2024

Procesmbajtësja,
Ilmije Rexhepi Beqiri

Anëtarët e kolegjit:
Skender Çoçaj

Kryetar i kolegjit,
Zyhdi Haziri

Ferit Osmani
